



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1447/ 9 Prot.,

Datë 02.06.2026

V E N D I M
Nr. 739 / 2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02.06.2026 me

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave të operatorëve ekonomikë “Skyline” ShPK dhe “Librari Dyrrahu” ShPK, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*” Mallra, me Nr. REF-81360-04-08-2026, me objekt “Blerje materiale didaktike për kopshte dhe çerdhe” me fond limit 6.266.500 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 20.04.2026 nga autoriteti kontraktor Qendra Ekonomike e Arsimit, Bashkia Fier.

Ankimues: Operatori ekonomik “Sofia Myftari” P.F me NIPT K42611766Q, Adresa: *Lagjja 18 Shtatori, Rr. Reshat Kokalari, objekti nr. 29/23, Gjirokastrë.*

Autoriteti Kontraktor: Qendra Ekonomike e Arsimit, Bashkia Fier.
Adresa: Lagjja “29 Nëntori”, Rr. “Kastriot Muço”, Fier.

Subjekte të Interesuar: Operatori ekonomik “Skyline SC” ShPK, me Nipt M51624039U Adresa: *Rr. Tulla 3, Z. Kadastrale 8320, Nr.pasurie 3/1431/ND, Nj Bashkiake nr.11, Tiranë.*

Operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” ShPK, me Nipt L91418502J, Adresa: *Z. Kadastrale nr.8517, Nd. 4 kate, Sip. trualli 1’000 m², Durrës.*

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe

funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraparak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datë 09.04.2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, *Mallra*, me Nr. REF-81360-04-08-2026, me objekt “Blerje materiale didaktike për kopshte dhe çerdhe” me fond limit 6.266.500 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 20.04.2026 nga autoriteti kontraktor Qendra Ekonomike e Arsimit, Bashkia Fier.

II.2 Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), rezulton se autoriteti kontraktor në datën 20.04.2026 ka zhvilluar procedurën e prokurimit dhe në përfundim të vlerësimit të ofertave në SPE, me dt.27.04.2026 kreu renditjen e operatorëve si vijon:

Operatorët ekonomikë	Vlerat e ofertave	Vlerësimi
1. KEJ Group ShPK	3. 509, 700	Skualifikuar, oferta anomalisht e ulët
2. ERVIN LUZI	3, 890, 000	Skualifikuar, oferta anomalisht e ulët
3. LIBRARI DYRRAHU ShPK	4,100,000	Kualifikuar

4. Skyline SC	4,198,540	Kualifikuar
5. SOFIA MYFTARI	4,699,900	Kualifikuar
6. InfoSoft Office ShPK	4,897,950	Kualifikuar
7. MARKETING & DISTRIBUTION ShPK	4,984,595	Kualifikuar
8. Telia Kurti P.F	4,999,000	Skualifikuar për kritere
9. Erblina Beqiri P.F	5,290,000	Skualifikuar për kritere
10. MIFEEL	5,393,900	Kualifikuar
11. O&A ShPK	5,480,000	Skualifikuar për kritere
12. IT Gjergji Kompjuter ShPk	5, 570, 000	Kualifikuar
13. BENNETT ShPK	5, 590, 000	Skualifikuar për kritere

II.3 Nga verifikimet e kryera në SPE, Autoriteti Kontraktor më datë 05.05.2026 ka publikuar Njoftimin e Fituesit Paraprak për procedurën e prokurimit.

II.4 Njëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2026/6635, datë 11.05.2026 dhe me Nr. 1447/2026 Prot., datë 12.05.2026, nga operatori ekonomik “Sofia Myftari” P.F, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*” Mallra, me Nr. REF-81360-04-08-2026, me objekt “Blerje materiale didaktike për kopshte dhe çerdhe” me fond limit 6.266.500 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 20.04.2026 nga autoriteti kontraktor Qendra Ekonomike e Arsimit, Bashkia Fier.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertave të operatorëve ekonomikë “Skyline” ShPK dhe “Librari Dyrrahu” ShPK në procedurën e prokurimit sipërcituar.

II.5 Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “b” dhe “c” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe Formularin e Publikimit nr. 1447/1 prot., datë 12.05.2026, lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë.

[...]Numri i ofertuesve të kualifikuar në procedurë është 7 (shtatë) si më poshtë:

1- LIBRARI DURAHU, me oferte ekonomike	4,100,000	“	Kualifikuar
2-Skyline, me oferte ekonomike	4,198,540	“	Kualifikuar
3-SOFIA MYFTARI, me oferte ekonomike	4,699,900	“	Kualifikohet
4-InfoSoft Office, me oferte ekonomike	4,897,950	”	Kualifikohet
5-Marketing & Dsitribution, me oferte	4,984.595	“	Kualifikohet
6- MIFFEL, me oferte ekonomike	5,393,900	“	Kualifikohet
7-IT Gjergji Kompjuter, me oferte ekonomike	5,557,000	“	Kualifikohet

Gjatë vlerësimit për ofertat anomalisht të ulët sipas përcaktimeve të LPP-se sipas nenit 82 pika 4, KVO ka vepruar në kundërshtim me LPP në fuqi. Duke vërejtur se tashmë ndryshon përsëri llogaritja e ofertave nga operatorët ekonomikë renditja do të ndryshojë.

Kërkojmë:

1-Autoriteti Kontraktori duhet të bëjë rivlerësim të fazës së procedurës

2-Duhet të kryeje sipas përcaktimeve të ligjit të prokurimeve publike skualifikimin e dy operatoreve ekonomik LIBRARI DURAHU dhe SKYLINE të cilët me përlllogaritjen dhe Ligjin e ri të prokurimeve rezultojnë si oferte anomalisht e ulët. [...].

II.6. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin administrativ rezulton, se janë paraqitur argumente nga operatorë ekonomikë të interesuar në kuptim të nenit 113 të LPP-së, i ndryshuar, e konkretisht nga operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” ShPK.

Referuar Formularit të Argumenteve, i cili mban datën 14.05.2026, ardhur nëpërmjet Sistemit dhe protokolluar me tonën me nr. 1447/2, datë 15.05.2026, operatori ekonomik ka kundërshtuar ankesën për skualifikimin e ofertës së tij :

[...] Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë: $O - \text{Oferta MO Mesatarja e ofertave të vlefshme } N - \text{Nr i ofertave të vlefshme PR (Zm) Zbritje e mundshme MO} = O1 + O2 + O3 + ? On / N PR = 85 \% Mo$ Vlera e ofertave të vlerësuara rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët . Në rastin Konkret: $MO = 3509700 + 3890000 + 4100000 + 4198540 + 4699900 + 4897950 + 4984595 + 5393900 + 5570000 = 41\ 244\ 585$ (mesatarja e ofertave të vlefshme) $Nr = 9$ (oferta të vlefshme) $MO / N = 41\ 244\ 585 / 9 = 4\ 582\ 731,6667$ $PR = 85 \% e MO = 85\% e 4\ 582\ 731,6667 = 3\ 895\ 321,91$ Pra ofertat të cilat janë me të vogla se $3\ 895\ 321,91$ konsiderohen anomalisht të ulta.

Sa më sipër rezulton se AK ka zbatuar saktë formulën duke skualifikuar ofertat e OE me vlerë $3\ 509\ 700$ dhe $3\ 890\ 000$ si oferta anomalisht të ulta dhe duke kualifikuar ofertën e OE tonë ekonomik si të sukseshme.

Pretendimet e ankesës nuk qëndrojnë.[...]

II.7. Komisioni me shkresën nr. 1447/3 prot., datë 21.05.2026, me objekt: *Kërkesë për Informacion*, drejtuar Sektorit të Financës pranë KPP, citon: *[...]Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dosjes konstatohet se mungon dokumenti bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse duke rezultuar “Paparqitur mandat pagesë”.*

Sa më sipër, me qëllim vijim e shqyrtimit të mëtejshëm të ankesës nga KPP, lutem përcjelljen e informacionit mbi statusin aktual të pagesës për ankesën me Nr. 1447/2026 Prot., datë 12.05.2026, nga operatori ekonomik “Sofia Myftari” P.F. [...]

II.8. Me shkresën ardhur në Sistem me nr. 265/14 Prot., datë 22.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 1447/4, datë 25.05.2026, si edhe e njejta shkresë ardhur me shërbim postar, protokolluar me tonën me nr. 1447/5, datë 25.05.2026, me objekt “*Informacion*”, autoriteti kontraktor ka përcjellë Vendimin e KSHA-së në lidhje me shqyrtimin e ankesës.

Referuar Vendimit Nr.265/13 Prot., datë 21.05.2026 të KSHA-së, autoriteti kontraktor ka vendosur mospranim të pretendimeve të ngritura në ankesë.

II.9. Me shkresën nr. 1447/6, prot., datë 25.05.2025, Sektori i Financës pranë KPP-së informon si vijon: *“Në përgjigje të kërkesës tuaj me nr. 1447/3 prot., datë 21.05.2026 me*

lëndë: Kërkesë për informacion, ju bëjmë me dije se, për ankesën me nr. ankimi elektronik A/2026/6635 dhe me Nr. 1447/2026 Prot., datë 12.05.2026, nga operatori ekonomik “Sofia Myftari” P.F, ka kryer e pagesës për tarifën e ankimimit në favor të KPP-së. Referuar raportit të dërguar nga Dega e Thesarit me datë 25.05.2026, për arkëtimet e kryera deri më datë 21.05.2026, rezulton se operatori ekonomik “Sofia Myftari” PF ka kryer pagesë në favor të Komisionit të Prokurimit Publik për ankesën e sipërcituar.”

III

Komisioni i Prokurimit Publik,

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si edhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesën e operatorit ekonomik “Sofia Myftari” P.F, me anë të së cilës kundërshton vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, argumentuar si vijon:

[...]Ofertat ekonomike nga operatorët janë si me poshte:

<i>1- Kej group 3,509,700 me oferte ekonomike leke pa TVSH</i>	<i>S,kualifikuar</i>
<i>2- ERVIN LUZI me oferte ekonmike ,3890,000 leke pa TVSH</i>	<i>S,kualifikuar</i>
<i>3- LIBRARI DURAHU me oferte ekonomike 4,100,000 leke pa TVSH</i>	<i>Kualifikuar</i>
<i>4- Skyline me oferte ekonomike 4,198,540 leke pa TVSH</i>	<i>Kualifikuar</i>
<i>5- SOFIA MYFTARI me oferte ekonomike 4,699,900 lekem pa TVSH</i>	<i>Kualifikuar</i>
<i>6- InfoSoft Office me oferte ekonomike 4,897,950 leke pa TVSH</i>	<i>Kualifikuar</i>
<i>7- MARKETING & DSITRIBUTION me oferte 4,987,595 leke pa TVSH</i>	<i>Kualifikuar</i>
<i>8- Telia KURTI me oferte ekonomike 4,999,500 leke pa TVSH</i>	<i>S,kualifikuar</i>
<i>9- Erblina Beqiri me oferte ekonomike 5,290,000 leke pa TVSH</i>	<i>S,kualifikuar</i>
<i>10- MIFFEL me oferte ekonomike 5,393,900 leke pa TVSH</i>	<i>Kualifikuar</i>
<i>11- O&A me oferte ekonomike 5,480,000 leke pa TVSH</i>	<i>S, kualifikuar</i>
<i>12- IT Gjergji Kompjuter me oferte ekonomike 5,557,000</i>	<i>Kualifikuar</i>
<i>13- BENNETT me oferte ekonomike 5,590,000 leke pa TVSH</i>	<i>S, kualifikuar</i>

Numri i ofertueseve te kualifikuar eshte 7 (shtate) si me poshte:

<i>1- LIBRARI DURAHU me oferte ekonomike 4,100,000 leke pa TVSH</i>	<i>Kualifikuar</i>
<i>2- Skyline me oferte ekonomike 4,198,540 leke pa TVSH</i>	<i>Kualifikuar</i>
<i>3- SOFIA MYFTARI me oferte ekonomike 4,699,900 lekem pa TVSH</i>	<i>Kualifikuar</i>
<i>4- Info soft Office me oferte ekonomike 4,897,950 leke pa TVSH</i>	<i>Kualifikuar</i>
<i>5- MARKETING & DSITRIBUTION me oferte 4,984.595 leke pa TVSH</i>	<i>Kualifikuar</i>
<i>6- MIFFEL me oferte ekonomike 5,393,900 leke pa TVSH</i>	<i>Kualifikuar</i>
<i>7- IT Gjergji Kompjuter me oferte ekonomike 5,557,000</i>	<i>Kualifikuar</i>

*Totali i ofertave eshte 7, 4,100,000 + 4,198,540 +4,699,900 +4,897,950 + 4,984.595 +5,393,900 +5,557,000 = 33,844,885 leke pa TVSH 33,844,885 / 7 = 4,834,983.57 4,834,983.57 * 85% = 4,109,736 leke. Niveli qe duhet te jete per te kualifikuar oferten eshte vlera 4,109,736 leke. Operatori ekonomik pjesemarres -LIBRARI DURAHU me oferte ekonomike 4,100,000 leke pa TVSH, rezulton te jete me oferte anomalisht te ulet sipas nenit 82 pika 4. KVO ka vepruar ne kundërshtim me LPP sipas nenit 82,*

Theksojme se gjate vlerësimit per ofertat anomalisht te ulet sipas percaktimeve te LPP-se sipas nenit 82 pika 4 , KVO ka vepruar ne kundërshtim me LPP ne fuqi. Duke verejtur se tashme ndryshon perseri llogaritja e ofertave nga operatorët ekonomike renditja eshte si me poshte:

Numri i ofertueseve te kualifikuar eshte 6 (gjashte) si me poshte:

1-Skyline me oferte ekonomike 4,198,540 leke pa TVSH Kualifikuar
2-SOFIA MYFTARI me oferte ekonomike 4,699,900 lekem pa TVSH Kualifikohet
3-Info soft Office me oferte ekonomike 4,897,950 leke pa TVSH Kualifikohet
4-MARKETING & DSITRIBUTION me oferte ekonomike 4,984.595 leke pa TVSH Kualifikohet
5-MIFFEL me oferte ekonomike 5,393,900 leke pa TVSH Kualifikohet
6- IT Gjergji Kompjuter me oferte ekonomike 5,557,000 Kualifikohet
Totali i ofertave eshte 6 (Gjashte) 4,699,900 +4,897,950+ 4,897,950+ 4,984.595+ 5,393,900+ 5,557,000= 30,431,295 leke pa TVSH. $30,431,295 / 6 = 5,071,882.5$
 $5,071,882.5 * 85\% = 4,311,100.12$ leke

Niveli qe duhet te jete per te kualifikuar oferten eshte vlera 4,311,100.12 leke. OE pjesemarrës -Skyline me oferte ekonomike 4,198,540 leke pa TVSH, rezulton te jete me oferte anomalisht te ulet sipas nenit 93 pika 4.

Ne rastin konkret kerkojme rivleresimin te procedures dhe skualifikimin e OE SKYLINE. KVO ka vepruar ne kundërshtim me LPP sipas nenit 82, Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave pika 4 Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.. [...]

III.1.1. Autoriteti Kontraktor me Vendimin e KSHA-së argumenton ndër të tjera në mënyrë të përmbledhur :

[...] AK ka zhvilluar procedurën e prokurimit dhe me dt 27.04.2026 ka vlerësuar ofertat. OE Sofia Myftari ka paraqitur ankesë në Sistem me anë të së cilës kërkon skualifikimin e OE Librari Dyrrahu ShPK dhe Skyline SC ShPK. Në lidhje me pretendimet e ankimesit KSHA nga shqyrtimi i Dokumenteve të Procedurës së prokurimi dhe në interpretim te nenit 82/2 te LPP ofertat jo te vlefshme janë ato që nuk përmbushin kriteret për kualifikim.

Referuar vlerësimit të ofertave të KEJ Group ShPK dhe Ervin Luzit P.F., janë skualifikuar për shkak të ofertave anomalisht të ulëta dhe për rrjedhojë konsiderohen oferta jo të vlefshme referuar edhe në VKM nr. 285/2021 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik.

III.1.2. Në nenin 93 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

4. Nëse një autoritet kontraktor konstaton se një ofertë është anomalisht e ulët për shkak se ofertuesi ka marrë ndihmë shtetërore, oferta mund të refuzohet vetëm për këtë arsye, vetëm pas konsultimit me ofertuesin, nëse ky i fundit nuk mund të provojë, brenda një afati kohor të përcaktuar nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet të jetë të paktën 3 ditë pune, që ndihma është marrë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.

III.1.3. Në nenin 82/4 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:
4. Pas korigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;

- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit/ët, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.

Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë: O - Oferta MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme N - Numri i ofertave të vlefshme PR (Z_m) – Zbritje e mundshme $MO = O1 + O2 + O3 + \dots + O_n / N$ $PR = 85 \% Mo$ Vlera e ofertave të vlerësuara $< .. PR$ rrydhimisht oferta është anomalisht e ulët.

III.1.4. Në Kreun II, “Kufijtë monetarë në sektorin klasik” të VKM-së nr.291, datë 15.05.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik”, përcaktohet se:

“1. Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon: a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000 000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë; b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë.

2. Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon: a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë; b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

III.1.5. Referuar Dokumenteve Standarde të Procedurës së Prokurimit, Vlerësimi i Ofertave, citohet:

Korigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta

1. Autoriteti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti i korigjon këto gabimesi më poshtë:
Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korigjohet në bazë të tij.

Në këtë rast, do të korrigojohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin. Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët, nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$

$PR = 85 \% Mo$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

III.1.6. Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik me synim vendosjen në pah të ratio legis, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se *ratio legis est anima legis*, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me

ligjin e prokurimit publik. Neni 94, pika 1 kërkon shprehimisht që, *ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.*

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se operatorët ekonomikë janë njoftuar në përputhje me parashikimet e ligjit për prokurimin publik në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO, i cili nga shqyrtimin i arsyeve të skualifikimit në procedurë konstaton, se AK ka kryer vlerësim duke kualifikuar ofertat e operatorëve ekonomikë të suksesshëm në përmbushje të kritereve të përgjithshme dhe të vecanta të kualifikimit me renditjen si vijon:

Operatorët ekonomikë	Vlerat e ofertave	Vlerësimi
1. KEJ Group ShPK	3 509 700	Kualifikuar
2. ERVIN LUZI P.F	3 890 000	Kualifikuar
3. LIBRARI DYRRAHU ShPK	4.100.000	Kualifikuar
4. Skyline SC ShPK	4.198.540	Kualifikuar
5. SOFIA MYFTARI P.F	4.699.900	Kualifikuar
6. InfoSoft Office ShPK	4.897.950	Kualifikuar
7. MARKETING & DISTRIBUTION ShPK	4.984.595	Kualifikuar
8. Telia Kurti P.F	4 999 500	Skualifikuar për kritere
9. Erblina Beqiri P.F	5 290 000	Skualifikuar për kritere
10. MIFEEL ShPK	5.393.900	Kualifikuar
11. O&A ShPK	5 480 000	Skualifikuar për kritere
12. IT Gjergji Kompjuter ShPk	5 570 000	Kualifikuar
13. BENNETT ShPK	5 590 000	Skualifikuar për kritere

Referuar Vlerësimin të Ofertave Ekonomike në SPE rezulton, se pas aplikimit të formulës për përlllogaritjet e ofertave anomalisht të ulëta, Autoriteti Kontraktor ka skualifikuar ofertat e operatorëve ekonomikë, KEJ Group ShPK dhe Ervin Luzi P.F. të cilat rezultuan me vlera anomalisht të ulëta.

III.1.7. Komisioni nga shqyrtimi i ankesës dhe dokumenteve të dosjes administrative vëren se, referuar Ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar, në zbatim të pikës 5 të nenit 93 të LPP-së se: *në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët*”, procedura e prokurimit objekt-shqyrtimi “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, Mallra, me objekt “*Blerje materiale didaktike për kopshte dhe çerdhe*” me fond limit 6.266.500 Lekë pa TVSh, zhvilluar nga autoriteti kontraktor, rezulton më vlerë të fondit limit nën kufirin e lartë monetar, referuar VKM-së Nr. 291, datë 15.05.2024 “*Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik*”.

Referuar Informacionit të AK-së, në lidhje me vlerësimin ofertave, të cilat në aplikim të formulës, *mbi vlerësimin e një oferte anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme*, rezultuan 2 oferta anomalisht të ulëta, dhe në referim të nenit 93 të LPP-së i ndryshuar, shtuar pika: *(5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e*

cila është konstatuar anomalisht e ulët.”), Autoriteti kontraktor ka skualifikuar dy ofertat sipër cituara në përputhje me bazën ligjore.

Nga shqyrtimi i ankesës, me pretendimet: *mbi skualifikim të operatorëve ekonomikë LIBRARI DYRRAHU ShPK dhe Skyline SC ShPK si edhe duke theksuar se KVO nuk ka zbatuar Ligjin dhe VKM, të ndryshuara, mbi ofertat anomalisht të ulëta*, Komisioni kreu hetim administrativ dhe konstaton, se procedura e prokurimit objekt ankimi është Procedurë e Hapur e Thjeshtuar, me fond limit nën kufirin e ulët monetar referuar dosjes së tenderit në seksionin “të dhënat kryesore” autoriteti kontraktor ka përcaktuar llojin e procedurës, çfarë do të thotë që mbi këtë parashikim verifikohet nga organet e shqyrtimit të ofertave dhe më tej hapat që duhet të ndiqen nga autoritetet kontraktore në rastin e konstatimit të ofertave anomalisht të ulëta, referuar kreut II të VKM-së nr.291, datë 15.05.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik”,

Komisioni gjykon se me vendimin e KVO-së, për skualifikimin e ofertave të operatorëve ekonomikë, të cilët në aplikim të formulës përkatëse, rezultuan me vlera anomalisht të ulëta konkretisht, ofertat e operatorëve ekonomikë KEJ Group ShPK dhe Ervin Luzi P.F, Autoriteti Kontraktor ka kryer vlerësim të drejtë dhe në përputhje me parashikimet e pikës 5, të nenit 93 të LPP-së, pasi procedura e prokurimit është nën kufirin e ulët monetar dhe autoritetet ose entet kontraktore kur ndodhen përballë një fakti të tillë, refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë e cila është konstatuar anomalisht e ulët.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se hapat proceduralë të ndjekur nga autoriteti kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, nuk kanë çenuar operatorët ekonomikë por përkundrazi ka vlerësuar ofertat në përputhje me bazën ligjore sipërcituar.

Akoma më tej, Komisioni për një vlerësim të drejtë dhe të paanshëm, mori në shqyrtim vlerësimin e ofertave ekonomike, në lidhje me aplikimin e formulës përkatëse për operatorët ekonomikë të mbetur në garë, pas vlerësimit të tyre në përmbushje të Kriterëve të Përgjithshme dhe të Veçanta të kualifikimit, e konkretisht konstatohet, se në garë kanë mbetur 9 operatorë ekonomikë dhe në aplikim të formulës përkatëse rezulton si më poshtë:

Mesatarja e 9 Ofertave: $3.509.700+ 3.890.000+ 4.100.000+ 4.198.540+ 4.699.900+ 4.897.950+ 4.984.595+ 5.393.900+ 5.570.000= 41.244,585/9 = 4,582,731.67 \times 85\%= 3,895,321^{91}$, dhe ofertat nën këtë vlerë do të vlerësohen anomalisht të ulëta, duke sjellë skualifikimin nga gara të operatorëve ekonomikë KEJ Group ShPK dhe Ervin Luzi P.F.

Për sa analizuar më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ofertat e operatorëve ekonomikë “Librari Dyrrahu” ShPK dhe “Skyline SC” ShPK, nuk rezultojnë oferta anomalisht të ulëta, sikurse ankimuesi pretendon në ankesën e tij dhe Vendimi i KVO-së është i drejtë dhe qëndron në fuqi.

Pretendimet e operatorit ekonomik nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të

Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Sofia Myftari” P.F për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” Mallra, me Nr. REF-81360-04-08-2026, me objekt “Blerje materiale didaktike për kopshte dhe çerdhe” me fond limit 6.266.500 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 20.04.2026 nga autoriteti kontraktor Qendra Ekonomike e Arsimit, Bashkia Fier.
2. Autoriteti kontraktor të vijojë me hapa të mëtejshëm procedurën e prokurimit sipërcituar.
3. Ngarkohet zyra e financës që të kryejë derdhjen e në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Sofia Myftari” P.F.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ, Tiranë.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro